



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 51
Prishtinë, 15 dhjetor 2009, në orën 11: 00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Teuta Hadri, Qamile Morina, Flora Brovina, Bujar Bukoshi dhe Nurishahe Hulaj.

Munguan: Mursel Halili dhe Gjylnaze Sylja.

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore dhe Fatime Qorri - zyrtare ligjore, nga KDI - Rrezarta Ahmeti dhe nga Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës - Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.
Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve

Sadik Idriz – Tha se nuk ka diçka të veçantë për të diskutuar lidhur me këtë projektligj në këtë fazë. Të vetmen dilemë që ka ishte a duhet t'i kemi dy ligje të ndara që kanë të bëjnë me Kryqin e Kuq të Kosovës? Me këto dy projektligje trajtohen dy çështje: organizmi i kryqit të kuq si organizatë dhe me emblemën e Kryqit të Kuq.

Qamile Morina – Bashkësia Evropiane nuk ka ligje për emblemat e Kryqit të Kuq, ato janë të rregulluara me konventa ndërkombëtare. Ne duhet të diskutojmë, nëse me të vërtetë kemi nevojë për ligje të tilla.

Flora Brovina – Tha se secili shtet ka disa komponentë dhe Kryqi i Kuq nacional numërohet një ndër komponentët e shtetësisë. Kam disa propozimamendamente, por ato do t'i propozoj pasi ky ligj ta ketë kaluar leximin e parë. Propozoi që Komisioni duhet t'i përkrahë këto projektligje në leximin parë.

Teuta Hadri – Tha se qëllimi i këtij projektligji është se Kryqi i Kuq i Kosovës duhet të dallohet nga Kryqi i Kuq i Serbisë, me një shenjë minimale të dallueshme.

Rita Hajzeraj – Tha se këto dy projektligje janë shumë të rëndësishme duke pasur parasysh që të gjitha shtetet i kanë këto ligje. Implikime buxhetore këto dy projektligje nuk kanë, atëherë si komision duhet t'i përkrahim në parim.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni përkrah miratimin në parim të Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të Kuq, të emblemave të tjera dalluese dhe të sinjaleve,

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës

Flora Brovina – Tha se ka disa propozimamendamente të cilat do t'i propozoj gjatë shqyrtimit të Projektligjit. Konkretisht në nenin 12 propozoj të shtohet një pikë, pra në kuadër të aktiviteteve tradicionale të Kryqit të Kuq, të përfshihet edhe dita e posaçme e personave të zhdukur. Pastaj në nenin 14 ka një propozimamendament, por këto çështje do të diskutohen pasi Projektligji të kalojë leximin e parë. Propozoj që edhe ky projektligj të përkrahët në parim.

Nurishahe Hulaj – Tha se në nenin 15, kur flitet për përgjegjësinë e institucioneve për zbatueshmërinë e këtij ligji, duhet të futet edhe Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, sepse ne mund të kemi gjendje të jashtëzakonshme mjedisore dhe këtu automatikisht vjen në konsiderim përgjegjësia e kësaj ministrie.

- *Kryesuesi konstatoi se Komisioni përkrah miratimin në parim të Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës.*
- *Gjatë shqyrtimit të këtyre dy projektligjeve Komisioni do të ftoj në takim përfaqësuesit e Kryqit të Kuq të Kosovës.*

5. Të ndryshme

a) Diskutim rreth shkresës së : P.P.F “Kondirolli”

Sadik Idriz – Njoftoi anëtarët e Komisionit me shkresën e P.P.F “Kondirolli” drejtuar Komisionit. Propozoi që Komisioni ta vizitojë kondirollin dhe të informohet më për së afërmi me gjendjen dhe arsyet e moslicencimit të kësaj kompanie.

Teuta Hadri – Tha se kondirolli ka punuar një kohë të gjatë dhe askush asnjëherë nuk ka pasur vërejtje në punën e tij. E ka aparaturën më moderne të punës. Nëse ne i kemi lejuar të punojnë institucionet private shëndetësore në shkallën më të lartë të shëndetësisë, pse të mos e lejojmë njeriun të punojë në shkallën më të lartë të farmacisë.

Qmile Mornina – U pajtua me propozimin që Komisioni të vizitoj këtë kompani dhe të njoftohet më për së afërmi me situatën, por gjithashtu duhet marrë informatën se cila është përgjigjja e MSh lidhur me kërkesën e kësaj kompanie për licencim.

Rita Hajzeraj – Tha se ne, si Komision, kemi dhënë rekomandim edhe për rilicencimin e “New Co – Farmakos”, kështu që ne do ta vizitojmë kondirollin dhe do të japim një rekomandim lidhur me këtë. Por, gjithashtu, duhet të ftojme në takim përfaqësues të inspektoratit dhe të MSh-së, sepse nuk kanë dhënë përgjigje lidhur me këtë.

Flora Brovina – Tha se ne, si Komision, vizitën duhet ta realizojmë sa më parë, në mënyrë që t’i ftojme përfaqësuesit e të dyja palëve në takim, në një nga mbledhjet e Komisionit.

b) *Takim me zyrtarët e UNDP- së*

Komisioni u takua me zyrtarët e UNDP-së, me të cilët diskutoi rreth mundësisë së përkrahjes së UNDP- së për Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për vitin 2010. Sipas përfaqësueses së UNDP- së, Nora Sahatçiu, ndihma mund të jetë e orientuar në dy dimensione: në sigurimin – prurjen e ekspertëve për ligje dhe shkëmbimi i përvojave me vendet e rajonit. Sipas UNDP-së nga vizita që Komisioni ka bërë në Bullgari është konstatuar se ligjet e Kosovës janë të një niveli të lartë, por problem është zbatueshmëria e tyre. Një përvojë e mirë, të cilën Komisioni mund ta marrë është koordinimi i Komisionit me Ministrinë e Shëndetësisë, që në çdo takim të Komisionit të marrë pjesë edhe një përfaqësues i MSh- së. Sa i përket plotësimit dhe ndryshimeve të ligjeve - përmbajta e ligjeve duhet të ruhet edhe pse ka nevojë shpeshherë për plotësime dhe ndryshime, sepse vetëm kështu mund të zbatohet reforma e filluar në shëndetësi.

UNDP mund të sjellë ekspert për ta bërë një studim të gjendjes reale, që lidhet me Ligjin për sigurime shëndetësore dhe me SISH- në, krahasimet me shtetet e tjera të na japë rekomandime si mund të veprojmë Komisioni që të dalë nga kjo situatë. Në të njëjtën kohë UNDP mund ta përkrahë një kampanjë për vendosjen e këtyre çështjeve, si çështje kryesore; në parlament, seanca, me publikun etj.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 15

E hartoi
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Sadik Idriz